



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:141546

Datë: 05.07.2024

Numri i dokumentit: 05902400

Ac.nr.5450/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj, kryetare e kolegjit, Faton Ademi dhe Besnik Bislimaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit SH.G nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson i autorizuari i tij avokat M.Q nga Prizreni, kundër të paditurës Ministria e Financave të Republikës së Kosovës – Administrata Tatimore e Kosovës, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson e autorizuar Shyhrete Gllogu, punëtoresh pranë të njëjtës, për shkak të kompensimit të dëmit nga marrëdhënia e punës, duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurës, e ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.337/17, i datës 29.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 01.07.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Ministria e Financave të Republikës së Kosovës-Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.337/17, i datës 29.03.2021 VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.337/17, i datës 29.03.2021, në pikën I (një) të dispozitivit e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit SH.G nga Prizreni dhe e ka obliguar të paditurën Ministria e Financave të Republikës së Kosovës – Administrata Tatimore e Kosovës, që paditësit SH.G ti kompensojë të ardhura personale të pa paguara për vendin e punës inspektor i administratës tatimore sipas kthimit në vendin e punës me vendim gjyqësor nga data 01.09.2006, deri më 12.10.2015, shumën në lartësi prej 44.902,35 euro, për pagat neto, me kamat ligjore prej 8 % nga dita e dorëzimit të padisë në gjykatë deri në pagesën e kësaj shume nga e paditura, në afatin 15 ditor pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Në pikën (dy) të dispozitivit e ka obliguar të paditurën Ministria e Financave të Republikës së Kosovës – Administrata Tatimore e Kosovës, që paditësit SH.G ti kompensoj tek organet kompetente për kontribut pensional nga i punësuarit shumën prej 2566.30 euro, për kontributin pensional nga punëdhënësi shumën prej 2566.30 euro, në afatin 15 ditor pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Në pikën III (tre) të dispozitivit e ka obliguar të paditurën Ministria e Financave të Republikës së Kosovës – Administrata Tatimore e Kosovës, që në emër të shpenzimeve procedurale t'i paguajë paditësit SH.G nga Prizreni, shumën prej 2006 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës në tërësi si e bazuar, të anulohet aktgjykimi i atakuar, të refuzohet kërkesëpadia e paditësi apo çështja të kthehet në rigjykim dhe në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur paditësi.

Gjykata e Apelit si Gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datë 20.03.2017 në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi, me të cilën ka kërkuar kompensimin e të ardhurave personale, për shkak se është larguar nga puna në mënyrë të kundërligjshme, dhe pas rikthimit në vendin e punës me vendim gjyqësor nuk i janë kompensuar të ardhurat personale, me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.337/17, i datës 29.03.2021, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar, së në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se, paditësi ishte në marrëdhënie pune tek e paditura deri në vitin 2006, kur edhe është larguar me vendim të komisionit disiplinor. Po ashtu nuk ishte kontestuese fakti se, fillimisht me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr.221/07 të datës 03.05.2011 paditësi është kthyer në vendin e punës apo se janë anuluar vendimet e të paditurës për ndërprerje të marrëdhënies së punës. Ky aktgjykim i Gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar edhe me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.147/2015 i datës

09.07.2015. Po ashtu nuk ishte kontestuese fakti se, përmes akt emërimit paditësi ka filluar përsëri të punoj tek e paditura me datë 12.10.2015, dhe atë për të zbatuar aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës.

Lidhur me pretendimin e paditësit që i njëjti është larguar nga puna në mënyrë të kundërligjshme nga e paditura, gjykata këtë e vërtetoi duke u bazuar në dispozitat e Ligjit të Punës përkatësisht nenit 80 dhe meqenëse paditësit pa të drejtë dhe me vendime të kundërligjshme i është ndërprerë marrëdhënia e punës nga ana e të paditurës atij i takojnë të gjitha benefitet të cilat kanë rrjedhë nga marrëdhënia e punës. Nëse kësaj ia shtojmë faktin se vet e paditura përmes vendimit fillimisht dhe akt emërimit e kthen paditësin në vendin e punës në të cilën ishte edhe para ndërprerjes nga vendimet e kundërligjshme (në vitin 2006) atëherë del qartë se e paditura duhet ti kompensojë paditësit të ardhurat nga marrëdhënia e punës.

Tutje gjykata për ta vërtetuar lartësinë e të ardhurave të cilat paditësi i kishte humbur si pasojë e vendimeve të kundërligjshme të paditurës gjykata ka marrë ekspertizë financiare të ekspertit Vehbi Imeri të datës 04.12.2020, e cila ekspertizë kishte përcaktuar saktë shumën të cilën e paditura duhet ti kompensojë këtu paditësit. Ekspertizës në fjalë gjykata ia falë besimin e plotë pasi që e njëjta është përpiluar në mënyrë profesionale duke u mbështetur në prova konkrete të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe janë në përputhje të plotë edhe me provat tjera materiale. Gjykata i ka vlerësuar edhe pretendimet e të paditurës se në procedurën përmbartimore e kishte kryer obligimin ndaj paditësit edhe sa i përket aspektit material apo të ardhurave që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, por se ka gjetur se, të njëjtat janë të pabazuara se, në procedurën e përmendur përmbartimore e paditura e kishte përmbushur obligimin e saj sa i përket shpenzimeve të procedurës të cilat kanë rrjedhur si pasojë e lëndës civile me nr. C.nr.221/07, pra shpenzimet procedurale të cilat i kishte pasur paditësi gjatë zhvillimit të procedurës janë përmbushur në procedurën përmbartimore. Gjykata ka konstatuar se kërkesëpadia e cila shqyrtohet në këtë çështje është kërkesë e re e paditësit me të cilën ka kërkuar që ti paguhet e gjitha ajo që do te i takonte po të mos i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës. Andaj, këto pretendime gjykata i ka vlerësuar si të pabazuara.

Gjykata e shkallës së parë lidhur me kamatën ka vendosur duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së. Ndërsa lidhur me shpenzimet e procedurës ka vendosur konform nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë ndërsa edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Edhe pse e paditura me ankesë e godet aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë duke pretenduar se i njëjti është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, e njëjta në përmbajtje të ankesës nuk e ka cekur asnjë arsye të vetme se ku i bazon pretendimet e saj se ku konsistojnë shkeljet e pretenduara, andaj meqenëse në këtë drejtim nuk është theksuar asnjë arsye e vetme lidhur me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës, e

meqenëse kjo Gjykatë ka gjetur se nuk ekzistojnë shkelje për të cilat Gjykata ankimore kujdeset sipas detyrës zyrtare e njëjta nuk do të lëshohet më tutje lidhur me këtë bazë.

Gjykata e Apelit vlerëson se, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditur për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak se për këtë gjykatë është i drejtë vlerësimi i gjykatë së shkallës së parë, kur ka konstatuar se paditësit i takojnë pagat për periudhën kontestuese. E paditura në ankesë pretendon se, gjykata e shkallës së parë e ka bazuar vendimin në kontratën e punës të paditësit pa specifikuar për cilën kontratë të punës është fjala, duke pretenduar se, paditësi për këtë periudhë nuk ka pasur kontratë të punës, ngase kontrata e punës i ka skaduar më datë 31.12.2006. Duke pretenduar se paditësi në atë periudhë nuk ka pasur marrëdhënie pune me të paditurën.

Me aktgjykimin e Gjykatës e Gjykatës Supreme të Kosovës, rev.147.2015 të datës 09.07.2015, është pranuar si i bazuar revizioni i paditësit dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, me nr.Ac.nr.3757.2012 i datës 11.02.2015, në pjesën e dytë të dispozitivit është Ndryshuar dhe është mbetur në fuqi aktgjykimi i Gjykatës Komunale të Prishtinës, C.nr.221/07 i datës 03.05.2011, në pjesën që i referohet detyrimit të të paditurës Ministria e Ekonomisë dhe Financave – Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, që paditësin Shqyeri Gashi ta ktheje në punë dhe detyrat e punës së Inspektorit në Administratën Tatimore të Kosovës, dhe ti kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore.

Në rastin konkret me vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës paditësi është kthyer në punë dhe me të njëjtin janë anuluar vendimet e të paditurës si të kundërligjshme me të cilat i është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe se është shumë e qartë se paditësi për periudhën kontestuese nuk ka pasur kontratë pune, mirëpo, meqenëse të njëjtit i është ndërprerë marrëdhënia e punës në mënyrë të kundërligjshme atëherë me kthimin e tij në punë i ka lindur e drejta edhe për kompensimin e të ardhurave personale për periudhën kontestuese.

Me dispozitën e nenit 80 të Ligjit të punës është paraparë që: *“Nëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore, në bazë të dispozitave të këtij ligji, Kontratës Kolektive ose Kontratës së Punës, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të ekzekutoj njërën prej këtyre dëmshpërblimeve: 1.1. t’i paguajë të punësuarve kompensimin, përveç shtesave dhe shumave tjera të cilat i takojnë punonjësit në bazë të këtij ligji, Kontratës së Punës, Kontratës Kolektive ose Aktit të Brendshëm, në shuma të tilla që gjykata i konsideron të drejta dhe adekuate, por të cilat nuk duhet të jenë më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshpërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit; ose 1.2. nëse largimi nga puna vlerësohet si i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, Gjykata mund ta rikthej të punësuarin në vendin e tij të punës dhe urdhëron kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna”*. Ndërsa në paragrafin 2 të këtij neni është paraparë se *“Punëdhënësi është i obliguar që në afatin e caktuar të zbatoj vendimin e gjykatës kompetente”*. Në rastin meqenëse paditësi është kthyer në punë dhe janë anuluar si të kundërligjshme vendimet e të paditurës atëherë të njëjtit i takon edhe kompensimi i pagave për periudhën të cilën i njëjti nuk ka qenë në punë për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies nga e paditura. Kështu që duke e pasur parasysh këtë gjendje faktike, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt

ka vepruar kur e ka bazuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Gjykata e Apelit vlerëson se shumat e aprovuara sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar janë në përputhje edhe me ekspertizën financiare të punuar nga eksperti Vehbi Imeri, të cilën ekspertizë Gjykata e Apelit e pranon në tërësi si profesionale, objektive dhe në përputhje edhe me shkresat e tjera të lëndës. Po ashtu eksperti, në mendimin e tij ka sqaruar periudhën kohore për pagat e pa paguara, pagën neto, pagën bruto, kontributin pensional e të gjitha këto për secilin muaj veç e veç dhe shumën e tërësishme duke marrë për bazë të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe atë të siguruar nga e paditura dhe Trusti i Kursimeve.

Meqenëse, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, Gjykata e Apelit vlerëson se edhe e drejta materiale është zbatuar si duhet dhe se e drejta e paditësit në kompensim të pagave gjen mbështetje të plotë në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe pretendimet e tjera ankimore, mirëpo konsideroi se të njëjtat janë të pa themelta dhe se e paditura me asnjë fakt apo provë nuk i ka bërë të besueshme pretendimet e saj me ankesë, ashtu që kjo Gjykatë të merrte vendim ndryshe nga ai sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së parë lidhur me kamatën ka vendosur duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së. Ndërsa lidhur me shpenzimet e procedurës ka vendosur konform nenit 452 të LPK-së.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195.1 pika d) , lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.5450/2021, me datë 01.07.2024

Kryetare e kolegjit
Hidajete Gashi Alaj, d.v.